REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk

Pa. nr. 08-12

Komisioni për Mbrojtjen e konkurrencës në bazë të nenin 28 dhe nenin 19 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10 dhe 136/11 dhe 41/14 dhe 53/16),), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga ,,Telemah" d.o.o. Ilixha-Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë me seli në adresën Xhemalla Bijediqa 216, Ilixha-Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë nëpërmjet Leonid Ristev, avokat nga Shkupi, në seancën e mbajtur me datë 28.02.2017, miratoi

AKTVENDIM

Vërtetohet përqendrimi me të cilin Telemah" d.o.o. Ilixha-Sarajevë („Telemach" d.o.o. Ilidja-Saraevo) me seli në adresën Xhemalla Bijediqa 216, Ilixha-Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë do të fitoj kontrollin e drejtpërdrejt të pavarur të pjesëve të caktuara të kompanisë ,,ASK" d.o.o. Ilixha- Sarajevë („ASK" d.o.o. Ilidja-Saraevo) me seli në rr. Ustaniçka nr.7/3, Ilixha, Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë, nëpërmjet blerjes së aksioneve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do ketë si pasojë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive në treg ose në pjesën themelore të saj, veçanërisht si rezultat të krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në pajtim me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim te nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

2. Obligohet parashtruesi i njoftimit për përqendrimin të paguaj taksë administrative të njoftimit për përqendrim në shumë prej 6 000,oo den. dhe për vendimin në shumën prej 30.000,oo den, sipas numrit të tarifës 28-a të Ligjit për taksa administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 и 95/05) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifra e të hyrave dhe programi 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon ekzekutimin e vendimit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (Gazeta Zyrtare nr. 145 / 10, 136/11, 41/14 dhe 53/16 në datë 30.12.2016, plotësuar më 01.02.2017, Telemah" d.o.o. Ilixha-Sarajevë („Telemach" d.o.o. Ilidja-Saraevo) me seli në adresën Xhemalla Bijediqa 216, Ilixha-Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë, në

përputhje me nenin 15 paragrafi (1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtutjeshëm: Komisioni) merr njoftimin për përqendrim me të cilin Telemah" d.o.o. Ilixha-Sarajevë do të fitoj kontrollin e drejtpërdrejt të pavarur të pjesëve të caktuara të kompanisë ,,ASK" d.o.o. Ilixha- Sarajevë („ASK" d.o.o. Ilidja-Saraevo) me seli në rr. Ustaniçka nr.7/3, Ilixha, Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë edhe atë nëpërmjet të blerjes së njësisë afariste të ,,ASK shpk Ilixha –Sarajevë, e cila merret me veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve të televizionit kabllor në komunës Ilixha.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit të përqendrimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të dhënave të parashtruara në Njoftimin e përqendrimit, plotësimin e Njoftimit dhe anekseve të tij konstatoi si më poshtë:

,,Telemah" d.o.o. është njëri nga operatorët e telekomunikacionit në Bosnje dhe Hercegovinë, aktive në ofrimin e shërbimeve të shpërndarjes së përmbajtjeve të medieve (nëpërmjet televizioni kallnor), internetit dhe telefonisë fikse deri te përdoruesit përfundimtarë. ,,Telemah" d.o.o. është nën kontrollin e plotë të fondeve të menaxhuara nga kompanitë të lidhura me kompaninë ,,KKR & Ko. L.P." (KKR & Co L.P.) një partneritet i themeluar në Delaver , me adresë primare në 9 Vest rruga e 57-të, Suit 4200, Nju Jork, Nju Jork 10019, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. ,,KKR" është një kompani globale e investimeve e cila vepronë në nivel global dhe e cila ofron një gamë të gjerë të mjeteve alternative dhe produkteve të tjera të investimeve për investitorët. ,,KKR" gjithashtu ofron zgjidhje në tregjet e kapitalit për kompanitë, kompanitë e portofolit të saj dhe klientët e tjerë. Fondet e investimeve private me të cilat menaxhon ,,KKR" investojnë në kompanitë me një numër të madh të sektorëve.

,,KKR" ka shoqërinë e saj të regjistruar në Republikën e Maqedonisë dhe kjo shoqëri e varur është ,,Total TV SHPK" Shkup, me seli të regjistruar në rr. Dame Gruev nr. 3, Qendër, Shkup, Republika e Maqedonisë, e cila merret me veprimtarinë e shpërndarjes së përmbajtjeve të medieve nëpërmjet platformës teknike DTH të SBB. Telemah d.o.o. dhe SBB janë pjesë të grupit Junajted Grup (United Group).

,,ASK" d.o.o. Ilixha-Saraevë është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara e cila në përbërjen e saj ka dy njësi të biznesit: njëra, e cila merret me veprimtarinë e radios (Radio ASK) dhe tjetra, e cila merret me veprimtarinë e shpërndarjes kabllore të përmbajtjes audio-vizuale të medieve për përdoruesit përfundimtarë.

Komisioni fillon me shqyrtimin e njoftimit për përqendrim në ditën e pranimit të tij dhe konstaton se përqendrimi bie nën dispozitat e Ligjit.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pika 6 (b) të Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës miraton aktvendim ne formë të shkurtuar, Komisioni konstaton se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, është në përputhje me të sepse nuk do ketë si pasojë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës

Rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk

efektive në treg ose në pjesën themelore të saj, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh vlerësimin e këtillë të përqendrimit, Komisioni vendosi ashtu siç parasheh dispozitivi i këtij aktvendimi, në pajtim me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës padia nuk e prolongon ekzekutimin e vendimit.

Mjeti juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për nisje të kontestit administrativ në Gjyqin administrativ në Republikën e Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
BLLAGOJ ÇURLINOV